

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Agim Maliqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarve: F.Sh. dhe F1.Sh1., për shkak të veprës penale trafikimi me njerëz në bashkëkryerje nga neni 139 par.2 lidhur me par.1 dhe 23 të KPK-së, ndërsa B.Q., L.P., F.N. dhe F.U., secili veç e veç për vepër penale trafikimi me njerëz nga neni 139 par.6 lidhur me par.5 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga Prokurori i Shtetit të Kosovës, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.NR.410/2017 datë 21.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18 qershor 2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit, konstatohet se me aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.410/2017 datë 21.12.2017, është shkelur ligji procedural, dispozita e nenit 384 par.1 pika 1.12 lidhur me nenin 361 par.2 dhe 370 par. 6 dhe 7 të KPPK në favor të dënuarve F.Sh., F1.Sh1., B.Q., L.P., F.N. dhe F.U.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Ferizaj - Departamenti për të mitur P.nr.82/09-PR 1 të dënuarit F.Sh. dhe F1.Sh1., janë shpallur fajtorë, për shkak të veprës penale trafikimi me njerëz në bashkëkryerje nga neni 139 par.2 lidhur me par.1 dhe 23 të KPK-së, ndërsa B.Q., L.P., F.N. dhe F.U., secili veç e veç për vepër penale trafikimi me njerëz nga neni 139 par.6 lidhur me par.5 të KPK-së dhe janë gjykuar me dënim me burgim : F.Sh., në kohëzgjatje prej 2 vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 8.9.2008 gjer më 28.10.2009, F1.Sh1., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e 6 (gjashtë ) muaj, B.Q.,

L.P., F.N. dhe F.U., secili veç e veç me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 2 (dy) vite. Janë detyruar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, solidarisht të paguajnë shumën prej 20 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej nga 100 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Me të njëjtin aktgjykim, ndaj të pandehurit B.G., konform dispozitës së neni 389 par.1 pika 1 të KPPK-së, është refuzuar akuza meqë Prokurori i Shtetit është tërhequr nga ndjekja penale për shkak të veprës penale trafikimi me njerëz nga neni 139 par.6 lidhur me par.5 të KPK-së.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.410/2017 datë 21.12.2017, me aprovimin e ankesave të mbrojtësve të dënuarve F.Sh., F1.Sh1., B.Q., L.P., F.N. dhe F.U., e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë ashtu që në pajtim me dispozitën e nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPK-së, i ka liruar nga akuza për veprën penale trafikimi me njerëz nga neni 139 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK, respektivisht, trafikimi me njerëz nga neni 139 par.6 lidhur me par.5 të KPK-së. E dëmtuara A.P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest civil. Në pjesën refuzuese në raport me të pandehurin B.G., aktgjykimi ka ngelur i paprekur.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prokurori i Shtetit të Kosovës, ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 370 par.7 dhe nenin 384 par.2 nënpar.2.1 të KPPK-së, si dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që kërkesa të aprovohet dhe të konstatohet se aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kanë dhënë të dënuarit F.U., L.P., avokati i të dënuarit F1.Sh1., H.N. nga F., mbrojtësi i të dënuarës F.Sh., av. A.V. nga P. dhe i dënuari B.Q., me propozim që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa, konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë, Prokurori i Shtetit pretendon se aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 370 par.7 të KPPK-së, se aktgjykimi është në kundërshtim me përmbajtjen e procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor dhe shkresat e çështjes, më pas Prokurori bën interpretimin e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 15.2.2017 lidhur me ballafaqimin e të dënuarit B.G. me deklaratën e tij të dhënë në Prokurori si dhe krahasimin e kësaj deklarate me deklaratën

e të dëmtuarës A.P. të dhënë në polici, për të theksuar se nga e njëjta rezulton se i dënuari B.G. i ka paguar të dënuarit F1.Sh1. 60 € për shërbimet e ofruara nga e dënuara. Theksohet se nga shkresat e çështjes rezulton se e dëmtuara A.P. ka qenë nën kontrollin e të akuzuarës F.Sh. Ceket se deklarata e F.Sh., të cilën e ka dhënë në Prokurori, është në kundërshtim me konstatimin e gjykatës së shkallës së dytë, ku kjo gjykatë konstaton se të dëmtuarën A.P., nuk e ka strehuar F., por motra e saj L. së bashku me burrin e saj S. Të gjitha këto prova gjykata e shkallës së dytë nuk i ka vlerësuar në përputhje me ligjin, kështu që për shkak të vlerësimit të gabuar të provave të administruara është shkelur edhe ligji penal në favor të dënuarve.

Janë të bazuara pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, nga këto arsye:

Në këtë çështje penale nuk kanë qenë kontestues disa fakte dhe atë: se të pandehurit F.Sh. dhe F1.Sh1., janë vëlla e motër F., ka jetuar në bashkësi familjare me motrën e të dëmtuarës A., dëshmitaren –L. që nga viti 2000 të cilën e ka kumatë, ndërsa e dëmtuara dhe motra e saj kanë ardhur për të jetuar në këtë shtëpi që nga viti 2004, meqë kanë mbetur pa prindër dhe përkujdesjen e askujt. Dëshmitarja L.P., ka qenë e punësuar ka punuar tek i dënuari L.P., i cili është djali i dajës së nënës së të dënuarve F. dhe F1., por ka punuar edhe në vende tjera, kështu që ajo shpesh ka punuar edhe nga 12 orë në ditë ndërsa motrat e saj-e dëmtuara A. dhe M., kanë qëndruar në shtëpi së bashku me F. e cila nuk ka qenë e punësuar. Sipas pohimeve të dëmtuarës A., ata e kanë detyruar të ketë marrëdhënie seksuale me të pandehurit të tjerë B.Q., L.P., F.N. dhe F.U., ndërsa si kundër shpërblim kanë marrë të holla dhe gjësende tjera. Për të gjitha këto fakte e dëmtuara në deklaratën e saj në detaje ka përshkruar përjetimet dhe veprimet e secilit të dënuar, deklaratë kjo që lidhur me disa fakte relevante, përputhet edhe me mbrojtjet e gjithë të pandehurve. Të pandehurit kanë mohuar faktin se kanë ndërmarr ndonjë veprim inkriminues ndaj të dëmtuarës. Edhe dëshmitarja L.P., ka pohuar se motrat e saj të mitur, për shkak të angazhimeve të saj në punë, shumicën e kohës kanë kaluar me të F. dhe kanë qenë nën kontrollin e dy të pandehurve të parë, madje ka shpjeguar edhe momentin kur ajo ka filluar që të dyshoj se diç po ndodhë me motrat e saj, kjo në bazë të sjelljeve të tyre dhe të pandehurës F., ashtu siç është elaboruar në faqen 19 të aktgjykimit të shkallës së parë. Pas kësaj kjo dëshmitare ka insistuar që motra e saj A., t'i tregojë se çfarë po ndodhë dhe pasi ka kuptuar, i ka preferuar të dëmtuarës që rastin ta denoncoj në polici. Bazuar në këto prova si dhe prova tjera të administruara, veprimet gjithë të pandehurve nuk vihen në dilemë me asnjë provë siç drejt ka konkluduar gjykata e shkallës së parë.

Mirëpo, gjykata e shkallës së dytë nuk e aprovon këtë konkludim dhe bazuar në të njëjtat prova nxjerr konkludimin si në vijim: “aktgjykimi bazohet vetëm në deklaratën e të dëmtuare A.P., që është në kundërshtim me dispozitën e nenit 262 të KPPK. E që gjykata nuk ka mundur të shpallë fajtorë të pandehurit vetëm në deklaratën e saj ngase

e njëjta nuk gjen mbështetje në prova tjera. Nga kjo del se në rastin konkret për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike është shkelur edhe ligji penal në dëm të akuzuarve”. Kjo gjykatë konstaton se aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 lidhur me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPPK, ngase nuk përmban arsye për faktet vendimtare që kanë të bëjnë me ndryshimin e vendimit të shkallës së parë, por konsideron të mjaftueshëm vetëm konstatimin i cili është cituar më sipër në këtë aktgjykim.

Bazuar në faktin se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur në dëm të pandehurve, kjo Gjykatë pranoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të bazuar dhe vetëm konstatoi ekzistimin e shkeljes së ligjit pa e prekur aktgjykimin e plotfuqishëm.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 438 par.2 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË  
PML.nr.126/2018, më 18 qershor 2018

Procesmbajtës,  
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,  
Nesrin Lushta